



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 55
Prishtinë, më datë 05 shkurt 2010, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

**I Mbledhjes së Komisionit të Shëndetësisë, Punës
dhe Mirëqenies Sociale**

Në mbledhje morën pjesë: Rita Hajzeraj, Teuta Hadri, Gjylnaze Sylja, Qamile Morina, Flora Brovina, Bujar Bukoshi. Kurse, munguan: Sadik Idriz , Nurishahe Hulaj dhe Mursel Halilji.

Të ftuar: Ministri i shëndetësisë Alush Gashi , ministri i Punës dhe Mirëqenies sociale Nenad Rashiq , përfaqësuesit e sindikatës së Pavarur të QKUK-së Xhemajl Selmani, Blerim Sylja dhe Sabri Hyseni si dhe përfaqësuesi i FSSHK, Asllan Bajrami .

Të pranishëm: Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit, Shpresa Haxhijaj - administratore dhe Fatime Qorri - zyrtare ligjore, Rrezarta Ahmeti – KDI dhe Petrit Hysa – OSBE.

Mbledhjen e kryesoi: Rita Hajzeraj, zv.kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i kërkesës së punëtorëve shëndetësorë për rritjen e pagave, miratimin e Ligjit për punën dhe Ligjit për sigurime shëndetësore;**
- 3. Të ndryshme.**

Kryesuesja konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

- 2. Shqyrtimi i kërkesës së punëtorëve shëndetësorë për rritjen e pagave, miratimin e Ligjit për punën dhe Ligjit për sigurime shëndetësore;**

Rita Hajzeraj – Komisioni ka pranuar një shkresë nga sindikata e pavarur e QKUK . Komisioni ka vlerësuar se kërkesat e punëtorëve shëndetësor të parashtruara janë kërkesa legjitime dhe janë

përkrahur njëzëri nga Komisioni. Ky takim ka për qëllim që të bisedohen dhe të shikohen mundësit e ministrive përkatëse dhe të Qeverisë së Kosovës për të gjetur zgjidhje për realizimin e kërkesave të punëtorëve shëndetësorë. Të ftuar i kemi përfaqësuesit e sindikatës së QKUK , përfaqësuesit e FSSHK , ministrin e shëndetësisë dhe ministrin e punës dhe mirëqenies sociale. Besoj se përmes këtij bashkëbisedimi do të kemi edhe rezultatet konkrete për realizimin e kërkesave të punëtorëve shëndetësorë.

Gjylnaze Sylja – Përshëndes mysafirët dhe shpresoj që ky takim do të jetë i suksesshëm për realizimin e kërkesave të punëtorëve shëndetësorë. Shqetësim i vazhdueshëm i Komisionit kanë qenë kërkesat të cilat janë paraqitur nga sindikata e punëtorëve shëndetësorë . Qëllimi i këtij takimi është të ndëgjojmë nga ministrat e ministrive përkatëse se deri ku kanë arritur në realizimin e kërkesave të parashtruara nga punëtorët shëndetësorë. Çështja e shëndetësisë kërkon një përqendrim të vazhdueshëm të Qeverisë dhe kjo duhet të ishte një çështje nacionale . Qëllimi i takimit nuk është mospajtimi në mes të sindikatave por gjetja e një zgjidhje për realizimin e katër kërkesave të parashtruara nga sindikata e QKUK- së.

Teuta Hadri – Ne kemi pranuar një kërkesë nga sindikata e punëtorëve shëndetësorë dhe si Komision njëzëri i kemi përkrahur këto kërkesa dhe kemi vendosur që të kemi një takim të tillë ku do të bëjmë përpjekje që të gjithë së bashku të gjejmë një zgjidhje. Është manipuluar shumë me pagat e punëtorëve shëndetësorë, prandaj duhet ta japim të gjithë kontributin tonë për gjetjen e një zgjidhje.

Bujar Bukoshi – Komisioni në mënyrë konsensuale i ka përkrahur kërkesat e punëtorëve shëndetësorë dhe se është pajtuar se të gjithë bashkërisht duhet ta gjejmë një zgjidhje. Çështja e shëndetësisë nuk është trajtuar me prioritet nga Qeveria, por as nga Qeveritë e më parshme. Si e koncepton ministria e shëndetësisë daljen nga kjo situatë dhe gjetjen e një zgjidhje?

Rita Hajzeraj – Ne na vjen keq që zëvendëskryeministri Kuçi, nuk ju ka përgjigjur ftesës sonë sepse Qeveria duhet ta gjej një zgjidhje. Buxheti për shëndetësi për këtë vit është miratuar dhe është një buxhet më i vogël se vitin e kaluar, dhe nuk është përfshi rritja e pagave. Duke marr parasysh që brenda ministrisë së Shëndetësisë nuk është parapa buxhet për rritjen e pagave, zgjidhja duhet të gjendet nga Qeveria dhe zëvendëskryeministri Kuçi do të ishte shumë më kompetent të na sqaronte se përse Ministria e Shëndetësisë nuk e ka buxhetin më të lart .

Flora Brovina – Komisioni ynë e përcjell situatën në shëndetësi dhe kemi qenë të interesuar të dimë nga ky bashkëbisedim se cilat mund të jenë mundësit e realizimit të kërkesave të punëtorëve shëndetësorë. Jemi shumë të interesuar që sa më par të miratohen ligji i punës dhe ligji për sigurime shëndetësore.

Xhemajl Selmani – Kërkesat tona janë miratimi i ligjit të punës dhe ligjit të sigurimeve shëndetësore, rritja e pagave duke u krahasuar me kolegët tonë në vendet e rajonit si dhe statusi i veçantë për QKUK- në. Pagat tona që 10 vite janë të njëjta, përveç dy viteve të fundit që janë rrit për 10 % , por na është premtuar edhe rritja këtë vit për 30%. Ju falënderoj për ftesën dhe interesimin tuaj për zgjedhjen e kërkesave tona. Në mënyrë statistikore kemi bërë disa përlllogaritje për të gjetur formën për rritjen e pagave tona.

Blerim Sylja – Kemi kënaqësi që marrim përkrahje nga ky Komision. Vitin e kaluar kemi pas 1 milion intervenime , nëse nga këto intervenime kishim marr vetëm nga 10 euro atëherë shuma do të ishte 10 milion euro . Rimbursimi në Shqipëri është 40 milion euro dhe ka një popullsi prej 4 milion banor ndërsa në Kosovë rimbursimin e kemi 20 milion euro dhe kemi një popullatë 2 milion banor , pra me Shqipërinë jemi bars. Ministri thotë se nuk ka buxhet por mendoj se buxhet ka por duhet ta shfrytëzojmë më racionalisht dhe ti ikim tenderizimit të buxhetit. Nëse 20 milionëshit të participimit ja shtojmë edhe 80 milionëshin e ndarë nga qeveria atëherë bëhen 100 milion .Nëse shkojmë me vet kontribut dhe nuk i lirojmë të gjitha kategoritë, por e bëjmë

ndarjen në tri kategori të popullatës sipas ligjit për sigurime shëndetësore , dhe të kemi pakot prej 1 euro deri në 10 euro, ku MPMS do të paguante për 40 % të popullsisë së papunë , 60 % e popullatës që punon në forma të ndryshme të paguan sigurimin shëndetësor . Nga përlllogaritja e këtillë në vit do të kemi rreth 140 milion euro mjete të grumbulluara dhe do të fillonim me implementimin e ligjit për sigurime shëndetësore.

Nëse ligjet do të ishin më të mira dhe më të zbatueshëm atëherë do të kishte mjete të mjaftueshme për shëndetësinë.

Asllan Bajrami – Kërkesat e shtruara për shqyrtim janë më pak se kërkesat e arritura në marrëveshjen e nënshkruar në mes të sindikatës e ministrisë së shëndetësisë dhe në prani të kryetarit dhe kryeministrit të vendit. Në këtë rast janë anashkalluar nga kjo temë edhe kërkesa të negociuara nga ne e që janë : Ligji për Grevat dhe Ligjin për Sindikatat , Ligji për pagat si dhe shtesat në paga për të gjithë punëtorët shëndetësor . Obstruksionet për realizimin e këtyre kërkesave janë paraqit nga vet nënshkruesit e kësaj marrëveshje e që janë përfaqësues të institucioneve qeveritare.

Kërkoj nga ky takim të mos përkrahen vetëm kërkesat e parashtruara në grevë të punëtorëve shëndetësor por të përkrahen dhe të shtyhen përpara të gjitha kërkesat e negociuara dhe të nënshkruara . Ngritja e pagës për 30% është e premtuar publikisht nga kryeministri , ndërsa 44 eurot janë pjesë e të hyrave vetanake .

Gjylnaze Sylja – Ky takim ka për qëllim që të shikohen mundësit e realizimit të kërkesave të parashtruar nga sindikata e QKUK-së. Marrëveshja e nënshkruar në mes sindikatës shëndetësore dhe Qeveris më herët asnjëherë nuk është zbatuar.

Alush Gashi – Një prej kërkesave më të rëndësishme të punëtorëve shëndetësor është ngritja e pagave të punëtorëve shëndetësor. Kjo temë do të ishte më e dobishme të zgjerohet me Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe me Ministrin për Ekonomi dhe Financa. Si ministër i shëndetësisë mund të ju ofroj të dhënat për të ardhurat në 2 vitet e fundit. Për arritjen e zgjidhjeve të shumë çështjeve duhet të bëhen ndërrime sistemore. Duhet të ndërrojnë raportet në mes të ministrisë së shëndetësisë dhe ministrisë së punës dhe mirëqenies sociale ku kërkohet që të mos jetë një numër kaq i madh i pacientëve që lirohen nga participimi shëndetësor.

Rita Hajzeraj – A ka parapa ministria e shëndetësisë ndonjë mundësi për rritjen e pagave të punëtorëve shëndetësor dhe ku është në procedurë Ligji për sigurime shëndetësore?

Alush Gashi - Ligji për sigurime shëndetësore ka përfunduar në ministrin e shëndetësisë dhe është dërguar me 17 nëntor 2009 në Ministrin e Ekonomisë dhe Financova për deklaratë financiar. Lidhur me pagat e punëtorëve shëndetësore, sipas fakteve të ministrisë së shëndetësisë paga e një mjeku specialist në janar të vitit 2008 ka qen 273 euro , ndërsa me 1 janar të vitit 2009 të gjithë shërbyesve civil ju është rritur paga për 10 % . Nga 1 janari 2010 rritja do të jetë 30% për mjek , ndërsa për kuadrin e mesëm do të jetë rritja për 44 euro, që të mos jetë 30 % sepse ju bie më e vogël se 44 euro. Nga janari i vitit 2010 të ardhurat e një specialisti do të jen 390 euro ndërsa për kuadrin e mesëm, në janar 2008 kanë qen 175 euro ,ndërsa në janar 2010 do të jetë 235 euro , pra rritje është për 40% . Jam i vetëdijshëm se edhe kjo rritje nuk mjafton por të gjithë jemi të përkushtuar të punojmë më shumë në reformat në shëndetësi.

Ligji i sigurimeve shëndetësore mund të hyj në fuqi si ligj i cili do të ketë ngritje graduale dhe jemi të përkushtuar që ky ligj të hyj në fuqi sa më parë. Me hyrjen në fuqi të ligjit të punës , ligjit të sigurimeve shëndetësore dhe ligjit të pagave dhe me nxjerrjen e punëtorëve shëndetësor nga shërbyesit civil pozita e tyre materiale do të përmirësohet dukshëm.

Nenad Rashiq - Ne në procedimin e ligjit të punës kemi pas mjaft vështërsi. Si jeni të informuar ligji i punës 3 here është ardhur në Parlament dhe prapë është kthyer në Qeveri si një ligj i cili është i papërbalueshëm për buxhetin e Kosovës. Ne kemi një buxhet shumë te vogël dhe grupet me te ndjeshme të shoqërisë janë të përfshira në ministrin e punës dhe mirëqenies sociale. Ligji i

punesë ka kaluar një histori dhe së fundi ne kemi bërë një analizë me bankën botërore dhe kemi përgatit draftin i cili është përcjell në ministrin e Ekonomisë dhe Financave për deklaratë financiare. Ligji është pjesë e një projekti të madh , pjesë e projektit për punësim të qëndrueshëm, projekt i cili do të filloj të zbatohet këtë vit.

Ligji i punës sipas strategjisë legislative të vitit 2010 është parapa të vije në Kuvend në fund të marsit. Sipas procedurës së paraparë ne pasi ta pranojmë ligjin nga Ministria e financave do ta shikojmë edhe një herë bashkë me bankën botërore dhe mandej do të procedohet për miratim në Kuvend.

Sa i përket asistencës sociale që u tha se marrin njerëz që nuk e meritojnë , kjo edhe mund të jetë e vërtet por ne kemi bërë përpjekje që ti zvogëlojmë parregullsitë dhe nga 37 mijë familje që marrin asistencë sociale , e kemi zvogëluar numrin për 2 mijë familje , jo nga ata që e meritojnë por nga ata që nuk e meritojnë.

Rita Hajzeraj – A besoni që këtë vit do të miratohet ligji i punës apo do të dështoj edhe këtë vit si ka dështuar në vitet e kaluara.

Nenad Rashiq – Besoj fuqishëm që këtë vit do ta kemi ligjin e punës. Në vitet e kaluara kemi gabuar në bazën e ligjit të punës pra kemi hartuar një ligj shumë të favorizuar për punëtorët dhe që është i papërbalueshëm për buxhetin e Kosovës . Këtë herë kemi vepruar në bashkëpunim me partnerët ton nga banka botërore dhe do ta kemi një ligj të punës të zbatueshëm.

Qamile Morina – Shëndetësia është në një gjendje të rëndë. Pagat e punëtorëve shëndetësor janë më të ulëta se disa ndihma sociale që jepen në Kosovë. Gjithmonë thuhet se ligjet e shëndetësisë janë të kushtueshme. Ligjet duhet të hartohen së bashku me ministrin e financave dhe tani nuk ka kuptim që ligji tani të shkoj në ministrin e financave. Pse po hartoni ligje, pa i pas ekonomistat gjatë hartimit .

Kryesorja janë pagat e punëtorëve shëndetësor dhe unë nuk po dëgjoj asnjë zgjidhje nga ministri. Paralajmërimet kanë qenë shumë të hershme nga punëtorët shëndetësorë. Sistemi shëndetësor fare nuk është reformuar . Çka po ofron ministria e shëndetësisë është shkatërrim i sistemit publik dhe po favorizon shërbimet private sepse shumë shërbime private po paguajnë në sektorin privat ndërsa sektori publik nuk po inkason asgjë. Ministria ende nuk e ka përpiluar një qmimore të shërbimeve shëndetësore.

Sot duhet që ministri i shëndetësisë të na tregoi mundësit e rritjes së pagave të punëtorëve shëndetësor.

Gjylnaze Sylja – Nxjerrja e punëtorëve shëndetësor nga kategoria e shërbyesve civil është e rëndësishme dhe është e lidhur edhe me rritjen e pagave të tyre . Çfarë hapash ka marr Qeveria në këtë aspekt , a është shtruar kjo çështje në Qeveri?

Kam informata nga punëtorët shëndetësor se me gjithë premtimin për rritje për 30% nga 1 janari 2010 ata nuk e kanë marr këtë rritje , a ka ministria e shëndetësisë informata për këtë?

Cili është koncepti i Qeveris për fillimin e zbatimit të ligjit të sigurimeve shëndetësore pasi që thuhet se ai ligj ka kosto prej 300 milion euro.

Pyetja për ministrin e punës se a mund të na siguroni se ligji i punës do të na vije në Kuvend ashtu si është parapa në strategjinë legislative?

Teuta Hadri – A do të dalim nga ky takim me një premtim për rritje të pagave të punëtorëve shëndetësor?

Bujar Bukoshi – A keni ndonjë plan veprimi, konkret për daljen nga kriza e krijuar me pagat e punëtorëve shëndetësor?

Flora Brovina – Sa i përket ligjit për sindikatat dhe ligjit për grevat , këto ligje janë stopuar nga Komisioni ynë për shkak të mos miratimit të ligjit të punës.

Sabri Hyseni – Në çoftë se doni me ndodhë edhe në Kosovë rasti që ka ndodh në Kroaci që mjekët i kanë lënë pacientët me vdekë në salla të operacionit, atëherë përgjegjësin do ta bart vet Qeveria. Ne ju kemi paralajmëruar kjo tani është në duart e Qeveris dhe në duart tuajat parlamentar të nderuar.

Paga e një motre në QKUK është 150 euro , e cila pagë nuk i mjafton për ushqim dhe për udhëtim, kjo pra nuk donë më tutje koment.

Asllan Bajrami – Ne i përkrahim kërkesat e punëtorëve shëndetësore dhe duhet të ketë rritje të pagave për një kohë të shkurt . Grandet qeveritare për preformanc nuk duhet të llogariten në 44 euro , 44 euro nuk janë rritje pagash por janë shtesë në çfarëdo page. Rritja e pagave për 30% është rritje e pastër e cila në është premtuar në bisedime me Qeverinë. Sa u përket ligjeve , kujt po i pengon të aprovohen ligjet që nuk kanë fare kosto, si ligji i pagave dhe ligji i grevave? Pagat nuk mund të rriten pa ligj të pagave.

Alush Gashi – Ju ftoj të gjithëve të jeni konstruktiv. Ftesa është bërë për të raportuar për ligjin për sigurime shëndetësore dhe ligjin e kemi përfunduar dhe e kemi dërguar në Ministrin e Financave . Gjithashtu ligji i pagave është miratuar në qeveri dhe është përcjell në Kuvend, ku në këtë ligj në nenin 3 punëtorët shëndetësor nxirren nga shërbyesit civil.

Rritja e pagave të punëtorëve shëndetësorë nga fillimi i mandatit tonë është bërë për 40 %.

Sabri Hyseni – Pyes ministrin e shëndetësisë se a e dinë se sa është paga e specialistit në janar të vitit 2010. Unë them se është 303 euro bruto ndërsa 44 euro nuk janë rritje, janë shtesë në pagë.

Xhemajl Selmani – Në janar 2010 ne i kemi marr kujdestarit për shtator dhe 44 euro për tetor dhe nëntor , ende nuk i kemi marr për dhjetor. Ministria e financave na tatimon në të gjitha të hyrat dhe kjo nuk është e drejt .

Nenad Rashiq – Jam i bindur se pas përfundimit të procesit, Ligji i punës do të vije në Kuvend në muajin Prill.

Qamile Morina – Sistemi shëndetësor ka probleme të mëdha . Populli i Kosovës është lodh dhe ne duhet tu përkushtohemi çështjeve të shtruara dhe jo çështjeve personale.

Rita Hajzeraj – A ka ministria e shëndetësisë strategji për të gjetur një zgjidhje ashtu si e shtroj pyetjen edhe dr. Bukoshi?

Alush Gashi – Ne si ministri e shëndetësisë e kemi përfunduar agjendën legjislativë , ndërsa rritja e pagave është bërë 10 % me 1 janar 2009 , ndërsa me 1 janar 2010 janë rritur edhe për 30%. Jemi në përkrahje të plot të ri organizimit dhe decentralizimit të QKUK së. Është e pavërtetë se nuk ka çmimore , ajo ekziston dhe vepron qe një vit.

Shtesa prej 44 euro që është marr më herët tani është shndërruar në rritje prej 30%, ndërsa ligjet e parapara në strategjinë legjislativë janë përmbush.

Asllan Bajrami – Nëse flitet për reforma në shëndetësi dhe nëse nuk është plani i veprimit me afate atëherë nuk ka reforma. Të gjitha reformat kanë dhimbje por duhet vazhduar.

Blerim Sylja – Në marrëveshjen e tetorit 2008 është parapa rritje pagave në mënyrë lineare për 44 euro që në përqindje bie, për motrat medicinale për 37%, ndërsa për mjekët 25 % . Në janar 2009 edhe 10% si të gjithë shërbyesit civil. Në janar të vitit 2010 ne kemi nënshkruar kontratat për tri vjet, me pagë bruto 303 euro. Kjo për ne është e papranueshme sepse nuk ka kurrfarë rritje nga viti 2008 kur është nënshkruar marrveshja.

Alush Gashi – Ministria e shëndetësisë është e gatshme që ta paraqes para komisionit strategjinë dhe planin e veprimit të kësaj ministrie.

Ju ftoj që të punojmë të gjithë së bashku në çështjet që janë të mundshme ti realizojmë.

Pres që me miratimin e ligjit të pagave do të bëhet ngritja e pagave të profesionistëve shëndetësor. Me nxjerrjen e punëtorëve shëndetësor nga shërbyesit civil ne do ti paguajmë mjekët sipas punës e jo sipas diplomës. Ligji për sigurime shëndetësore punëtorëve shëndetësor do të ju lehtësoj punën shumë.

Rita Hajzeraj – I falënderojmë të gjithë për pjesëmarrjen. Gjendja në shëndetësi është një gjendje reale e cila i shqetëson të gjithë. Komisioni do të miratoj edhe rekomandime konkrete për Qeverinë e Kosovës, që sa më par të gjendet një zgjidhje dhe pagat e punëtorëve shëndetësor të rriten.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00

Përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Zv. Kryetare e Komisionit

Rita Hajzeraj